



Pranimi / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivety	25.10	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicika Quantity
SKIMSHACK	6696/2023		118



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1153/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1153/2023 të datës 11.09.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted], me adresë rr. [redacted], në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", kundër Vendimit Nr.08/27-658-2-2023 i datës 09.08.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 25.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1153/2023 e datës 11.09.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.08/27-658-2-2023 i datës 09.08.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] me datë 11.09.2023 me numër protokolli 6054/2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Nr.08/27-658-2-2023 të datës 09.08.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe ankesave i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me pretendimet ankimore se veprimet që janë ndërmarrë nga KQZ, nenin 66 paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe nenin 125 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pala ankuese propozon që ti aprovohet ankesa dhe të anulohet

Vendimi me numër Nr.08/27-658-2-2023 i datës 09.08.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.09.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komisioni Qendror Zgjedhor, ndërsa Këshilli më datë 04.10.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komisioni Qendror Zgjedhor, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokolli 60544/2023 të datës 11.09.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga R.M. për ankesa.kpmschck@rks-gov.net. i datës 11.09.2023; E-mail nga R.M. për ankesa.kpmschck@rks-gov.net. i datës 12.09.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 27.09.2023; Përgjigje në ankesë e datës 04.10.2023; E-mail nga V.B. për C.Z. i datës 28.09.2023; Konkursin e shpallur nga KQZ të datës 30.01.2023; Vendim për themelimin e Komisionit Përzgjedhës në Sekretariatit e Komisionit Qendror Zgjedhor me numër nr.02-184-2023 i datës 20.02.2023; Akt Emërim me numër Nr.42/2010 i Z.S. i datës 28.03.2012; Akt Emërim me numër 685/2019 i F.L. i datës 02.07.2019; Ndryshim dhe plotësimi i aktit të emërimit me numër 67-4-2019 i M.M. i datës 04.02.2019; Akt Emërim me numër 02/1268 i N.H. i datës 24.10.2022; Ndryshim dhe plotësimi i aktit të emërimit me numër 71-2-2019 i V.K. i datës 04.02.2019; Kërkesa për punësim e R.M. i datës 06.02.2023; Certifikatë e lindjes me numër L25022353 i R.M. i datës 03.02.2023; Certifikatë e vendbanimit me numër B10434945 i R.M. i datës 03.02.2023; Letërnjoftim i R.M.; Certifikatë mbi dënimet penale e R.M. i datës 03.02.2023; Vendim nga MASHT me numër Ref.nr. 6-1534 i datës 20.03.2018; Diplomë Universiteti me numër Nr.2013-778 e R.M. i datës 09.09.2013; Vërtetim i kopjes dokumentit origjinal numri rendor LRP/767/2023; Shkresë e studentit e R.M. i datës 09.09.2013; Diplomë Universiteti me numër Nr.25-02-0000688 e R.M.; Vërtetim i kopjes dokumentit origjinal numri rendor LRP 766/2023; Kualifikimet e R.M.; Vlerësimi i performancës 2022 nga Komuna e Mamushës për R.M. i datës 12.01.2023; Vlerësimi i performancës 2021 nga Komuna e Mamushës për R.M. i datës 06.01.2022; Vendim nga MASHT me numër Ref.nr. 6-1535 i datës 20.03.2018; CV e R.M.; Certifikatë e studentit e R.M. e datës 15.01.2021; Kualifikimet akademike i datës 02.02.2023; Vendim me numër nr.23/2023 i datës 03.02.2023; Pasqyra e llogarisë së trustit e R.M. i datës 01.12.2017-31.01.2023; Certifikatë nga BFP për R.M. i datës 30.11.2017; Certifikatë nga AQH për R.M. i datës 07.11.2018; Certifikatë nga Usaid për R.M. i datës 12.12.2018; Certifikatë nga CISR për R.M. e muajit Qershor 2021; Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga divizioni i personelit SKQZ i datës 06.02.2023; Kërkesa për punësim e L.A. i datës 10.02.2023; Deklaratë e L.A.; Certifikatë mbi dënimet penale e L.A. i datës 31.01.2023; CV-ja e L.A.; Shkresë e L.A. Drejtor i firmës Mufa d.o.o. i datës 06.01.2023; Ekstrakt nga sigurimi në Republikën e Slovenisë i L.A.; Vërtetim nga SKQZ për L.A. e vitit 2023; Vërtetim nga SKQZ për L.A. i datës 31.12.2017; Letër rekomandim për L.A. i datës 26.03.2021; Letër Rekomanduese për L.A. i datës 10.01.2018; Pasqyra trustit; Shkresë me numër nr.439 i datës 08.02.2023; Letërnjoftim i L.A.; Diplomë nga Kolegji Pjetër Budi për L.A. me numër nr.-230 i datës 27.12.2012; Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga divizioni i personelit SKQZ i datës 10.03.2023; Raport nga kryesuesi i komisionit përzgjedhës mbi përgatitjen e listës së ngushtë për pozitën KQZ-05/2020 Zyrtar i Lart Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë i datës 23.02.2023; Raport final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i KQZ i datës 07.03.2023; Njoftim për kandidatin e

suksesshëm nga KQZ i datës 10.03.2023; Ankesë me numër nr.09-313-2023 e R.J. i datës 23.03.2023; Autorizim nga R.M. për A.Sh. i datës 21.03.2023; Vendim nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave KQZ me numër nr.08/27-455-2023 i datës 20.04.2023; E-mail nga V.B. për rstmzrk@hotmail.com i datës 20.04.2023; Vendim nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave KQZ me numër nr.08/27-658-2023 i datës 17.05.2023; Deklaratë nën betim me numër nr.09-381-2023 i datës 07.04.2023; Vendim nga KQZ për anulimin e konkursit me numër reference KQZ-05/2023 Zyrtar i Lart Komunal i Zgjedhjeve Mamushë me numër nr.02-396-2023 i datës 07.04.2023; Ankesë nga L.A. për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave KQZ me numër nr.09/446-2023 i datës 19.04.2023; E-mail nga V.B. për L.A. i datës 10.03.2023; Certifikatë nga creative education për L.A.; E-mail nga V.B. për L.A. i datës 23.03.2023; E-mail nga L.A. për V.B. i datës 23.03.2023; E-mail nga L.A. për V.B. i datës 28.03.2023; E-mail nga V.B. për L.A. i datës 28.03.2023; Kontrata mbi shfrytëzimin e paluajtshmërisë me qira e datës 08.12.2021; Transakcionet e konsumatorit nga kkefe kesco kpse për F.M. 01.01.2022-31.12.2023; E-mail nga V.B. për L.A. i datës 07.04.2023; E-mail nga V.B. për rstmzrk@hotmail.com i datës 10.03.2023; E-mail nga V.B. për L.A. i datës 10.03.2023; Përcaktimi i kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 03.03.2023; Përmbledhja e vlerësimeve individuale nga KQZ Form.KQZ-R-09; Renditja përfundimtare e kandidatëve nga KQZ Form.KQZ-R-10; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë i datës 23.02.2023; Pikët e kandidatëve nga anëtarët e komisionit, të cilët kanë aplikuar për pozitën ZLKZ në Mamushë 1/5 faqe i datës 23.02.2023; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.KQZ-R-08a për L.A. 1/5 faqe; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.KQZ-R-08a për R.M. 1/5 faqe; Vendim i KPMSHCK me numër protokoll 5361/2023 i datës 26.07.2023; Kallëzim penal me numër nr.02/884-2023 i datës 07.08.2023; Kërkesë për verifikim të kandidatit për procesin e rekrutimit të pozitës Zyrtar i Lart Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë me numër nr.02-334/2023 i datës 27.03.2023; E-mail nga A.N. për B.A. i datës 02.08.2023; E-mail nga B.A. për A.N. i datës 28.07.2023; Dokumentacion shtesë lidhur me kërkesën e datës 27.03.2023 Nr.02/334/2023 me numër protokoll 02/334A-2023 i datës 14.04.2023; Vërtetim nënshkrimi me numër LRP.nr.256/2021 nga Noteri B.L.; Deklaratë nën betim me numër nr.09-928/2023 i datës 29.08.2023; E-mail nga V.B. për C.Z. i datës 24.10.2023; Vendim me numër Nr.08/27-658-2-2023 i datës 09.08.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 30.01.2023 ka shpallur konkursin publik për gjashtë (6) pozita të lira, prej tyre edhe pozitën me shifër "KQZ-05/2023-Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë", ndërsa sipas shkresave të lëndës konstatohet se në këtë konkurs për pozitën e lartcekur ka aplikuar [redacted] i cili ka arritur të fitoj 64.4 pikë, ku kandidati [redacted] i cili sipas Njoftimit të datës 10.03.2023 të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve rezulton se pas përfundimit të procedurës së rekrutimit i njëjti është shpallur kandidatë i suksesshëm për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë" pasi që ka arritur të fitoj 82.2 pikë.

Tutje, Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përmes Vendimit me numër 02-396-2023 të datës 07.04.2023 ka anuluar konkursin për pozitën "KQZ-05/2023-Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë", me arsyetimin se sipas nenit 1.2 të Ligjit Nr.02/L-37, për përdorimin e gjuhëve, në nivelin komunal gjuhët tjera të bashkësisë si gjuha turke, boshnjake dhe rome janë gjuhë në përdorim zyrtarë të cilat kandidati i suksesshëm nuk i njeh, si dhe mbi bazën e "Deklaratës nën Betim" nga F.M të pranuar me datën 07.04.2023 nga Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së sipas së cilës deklaratë ankuesi pavarësisht që ka marr banesë me qera nga deklaruesi F.M, i njëjti asnjëherë nuk ka banuar në Mamushë.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin numër 02-396-2023 të datës 07.04.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me pretendimet ankimore se sipas konkursit të datës 30.01.2023 për pozitën me shifër "KQZ-05/2023" njohja e gjuhëve të tjera zyrtare konsiderohet si përparësi dhe e njëjta nuk ka qenë obligative, aplikacioni ka qenë i kompletuar sipas kriterëve të përcaktuara të konkursit me dëshminë se vendbanimi i tij është Komuna e Mamushës, ndërsa ka theksuar faktin se Vendimi numër 02-396-2023 i datës 07.04.2023 i Kryeshefit Ekzekutiv ka qenë në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative pasi nuk ka përmbajtur udhëzimin për këshillën juridike, me kërkesën se parashtrimi i ankesës duhet të pezullojë prodhimin e pasojave juridike të akteve që goditen.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave përmes Vendimit me numër 08/27-658-2023 të datës 17.05.2023 e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 19.04.2023 ndërsa ka lënë në fuqi Vendimin me numër 02-396-2023 të datës 07.04.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për anulimin e konkursit në fjalë në të cilin ankuesi kishte rezultuar kandidatë i suksesshëm, me arsyetimin se ankuesi nuk ka pasur pretendim ankimor në lidhje me çështjen faktike të ngritur nga deklarata e M.F në cilësinë e qiradhënësit të ankuesit, por vetëm ka ngritur pretendimin për mos shkëputje të kontratës së qirasë, kurse lidhur me pretendimin se njohja e gjuhëve të tjera zyrtare është përparësi dhe nuk është e obligueshme Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka gjetur se është pretendim i qëndrueshëm.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar shpalljen e konkursit të datës 31.01.2023 për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë" ku ndër të tjera është paraparë si kriter që "Kandidatët të cilët aplikojnë për pozita Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve (ZLKGJ) duhet të jenë persona me të drejtë vote në komunat e tyre përkatëse", nga rrjedh se kandidatët për pozitën e lartcekur duhet të jenë persona me të drejtë vote në komunën përkatëse, pra të jenë të evidentuar në listën e votuesve të komunës përkatëse e cila mirëmbahet dhe aranzhohet nga KQZ, sikurse përcaktohet me nenin 7 paragrafi 7.1 dhe 7.3 të Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës theksohet së " 7.1 KQZ-ja mban Listën e Votuesve dhe siguron që Lista e Votuesve është e saktë dhe e azhuruar, dhe e njëjta përmban: a) ekstraktin më të vonë në dispozicion nga Regjistri Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si qytetar të Kosovës sipas Ligjit për Shtetësinë; b) të gjithë votuesit me të drejtë vote jashtë Kosovës të cilët në mënyrë të suksesshme kanë aplikuar për votim jashtë Kosovës. 7.3 Për konfirmimin e të drejtës për votim, KQZ-ja ka qasje në regjistra, të dhëna për vendbanim dhe të dhëna të tjera zyrtare.", mirëpo nga shkresat e ofruara në cilësi të provave të

dërguara në Këshill përmes shkresës së datës 04.10.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bashkangjitur edhe kopjen e letërnjoftimit të ankuesit me Nr. Personal:1171563697 dhe numër të ID2020637 i lëshuar me datë 13.12.2021, sipas së cilit dokument konstatohet fakti se vendbanimi i ankuesit është në Mamushë, prandaj në rrethanat e rastit konkret Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka vepruar gabimisht kur ia ka falur besim vetëm njëres provë, respektivisht deklaratës së dhënë nga personi F.M, rrjedhimisht nuk ka arritur të konstatojë drejtë gjendjen faktike, pasi që sipas kopjes së letërnjoftimit të ankuesit të lëshuar me datë 13.12.2021 dëshmohet se vendbanimi i ankuesit është në Mamushë, prandaj mbështetur në dispozitat e nenit 7 paragrafi 7.1.a dhe 7.3 të Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, duke qenë se Komisioni i Ankesave është organ që vepron në kuadër KQZ-së ka mundur të kërkojë nga personat përgjegjës brenda institucionit që të bëjë verifikimin nëse ankuesi sipas letërnjoftimit të paraqitur ka të drejtë vote në Komunën e Mamushës, mirëpo nga arsyetimi i goditur përmes kësaj ankese konstatohet fakti se një veprim të tillë procedural me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk e ka ndërmarë në mënyrën e duhur, pasi që përmes emalit të datës 23.03.2023 dërguar nga zyrtari P.R "Zyrtar i Lartë i bazës së të Dhënave" për Kryeshefin Ekzekutiv të Sekretariatit të KQZ-së ishte dëshmuar se ankuesi për zgjedhjet e vitit 2017, 2019 dhe 2021 ka qenë pjesë e listës votuese në Komunën e Suharekës, mirëpo komisioni në fjalë është dashur ta ketë parasysh faktin se azhurnimi i listës së votuesve lidhur me zgjedhjet e fundit lokale për vitin 2021 të mbajtura me datë 17.10.2021, logjikisht më së voni ka mundur të azhurnohet deri në të njëjtën datë, pra datën e mbajtjes së zgjedhjeve, kurse data e lëshimit të letërnjoftimit të ankuesit është e mëvonshme respektivisht data 13.12.2021, sikurse është i njohur fakti se marrëdhënia e punë lidhet për të ardhmen, madje edhe konkursi është shpallur me datë 31.01.2023, prandaj Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike pasi që nuk ka arritur të konstatoi saktë qendrën e votimit të ankuesit në kohën e aplikimit sipas konkursit të datës 31.01.2023.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 08/27-658-2023 të datës 17.05.2023 ka vepruar drejtë kur e ka aprovuar pretendimin ankimor të ankuesit se nuk ka qenë obligative njohja e gjuhëve të tjera zyrtare, pasi që sipas konkursit të datës 30.01.2023 për pozitën me shifër "KQZ-05/2023-Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë", në pikën 4 dhe 6 lidhur me kriteret e konkursit është përcaktuar si në vijim: "4. Shkathtësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në njërën nga gjuhët zyrtare; 6. Njohja e gjuhës tjetër zyrtare konsiderohet si përparësi", prandaj mbështetur mbi këtë konstatim del se nuk ka qenë obligative njohja e gjuhës turke në rastin konkret, madje në konkursin në fjalë nuk është kërkuar të paraqiten dëshmi për njohjen e gjuhës turke.

Prandaj, nga sa u tha si më lartë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 08/27-658-2023 të datës 17.05.2023 përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 19.04.2023, ka vepruar gabimisht pasi që nuk ka arritur të konstatoi drejtë gjendjen faktike lidhur me vendbanimin e ankuesit ndërlidhur me listën votuese, sikurse arsyetimi i vendimit të goditur është kundërthënës me diapozitivin dhe në të njëjtën kohë edhe i mangët pasi që në arsyetim e aprovon apo e pranon si të bazuar pretendimin ankimor lidhur me kriterin e konkursit sa i përket gjuhës zyrtare ndërsa në diapozitiv e refuzon në tërësi ankesën e të njëjtit, kurse lidhur me

pretendim sa i përket vendbanimit ndërlidhur me të drejtën e votës nuk e arsyeton mjaftueshëm, respektivisht nuk ka arritur të konstatoj dhe shpjegojë saktë gjendjen faktike sikurse është konstatuar edhe më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, prandaj mbështetur ne dispozitat e nenit 52 nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative sikurse përcaktohet: "1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 02.06.2023 ka pranuar ankesën e ankuesit [redacted] kundër Vendimit Nr.08/27-658-2023 të datës 17.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe ankesave i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me pretendimet ankimore se i njëjti ka plotësuar kriteret e konkursit që ndërlidhen me të drejtën për të aplikuar në komunën përkatëse si në konkursin e shpallur për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë" nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, (tani e tutje KQZ), me arsyetimin se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e refuzimit të ankesës së tij të datës 19.04.2023 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr.02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve dhe dispozitat e ligjit material dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij ngase nuk ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 26.07.2023 me numër protokollit ka nxjerr vendimin me të cilin Anulohet Vendimi Nr.08/27-658-2023 i datës 17.05.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ndërsa lëndë kthehet në *rishqyrtim* dhe *rivendosje* tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave duke rivendosur sipas obligimit nga vendimi i Këshillit i datës 26.07.2023, në lidhje me ankesën nr.09/446-2023 të datës 19.04.2023 për anulimin e vendimit me numër 02-396-2023 të datës 07.04.2023 të paraqitur nga ankuesi [redacted] Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor ka nxjerrë vendim me numër protokollit Nr.08/27-658-2-2023 me datë 09.08.2023 me të cilin aprovohet ankesa nr.09/446-2023 e datës 19.04.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted] për anulimin e vendimit me numër 02-396-2023 i datës 07.04.2023, Anulohet vendimi me numër 02-396-2023 të datës 07.04.2023 i Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, për anulimin e konkursit me numër reference KQZ-05/2023 Zyrtar i Lart Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë dhe Mbetet në fuqi Njoftimi për kandidatin e suksesshëm [redacted] për pozitën Zyrtar i Lart Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë i datës 10.03.2023 si dhe çdo veprim procedural i ndërmarrë deri në nxjerrjen e vendimit nr.02-396/2023 i datës 07.04.2023 i Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit Qendror të Zgjedhjeve.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të shkresave të lëndës të dorëzuara nga organi i punësimit ka konstatuar që procedura e rekrutimit për pozitën "Zyrtar i Lart Komunal i Zgjedhjeve" në Mamushë e shpallur me datë 30.01.2023 nga Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, është bërë në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ku është përcaktuar se: "Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe

paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës", me rastin e shpalljes së konkursit publik.

Po ashtu Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Sekretariati i Komisionit Qendror Zgjedhor për pozitën "Zyrtar i Lart Komunal i Zgjedhjeve" në Mamushë me rastin e njoftimit për kandidatin e suksesshëm ka vepruar në pajtim me Rregulloren Nr.03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Zgjedhor konkretisht nenin 31 paragrafin 1, 2 dhe 3 ku përcaktohet se: 1. Në Sekretariat emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë. 2. Pikët e përgjithshme në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë mbledhen dhe pjesëtohen për dy). 3. Kandidat i suksesshëm konsiderohet ai i cili në testin e përgjithshëm (testin me shkrim dhe intervistën me gojë) është vlerësuar me numrin më të madh të pikëve, jo më pak se 60% të pikëve në total.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu konstaton se përzgjedhja e kandidatit është bërë në pajtim edhe me dispozitat e nenit 40 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: "Në shërbimin civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë", "Kandidat i suksesshëm konsiderohet ai, i cili në testin e përgjithshëm (testin me shkrim dhe me gojë) ka jo më pak se 60% të maksimumit të pikëve të caktuara", në rastin konkret konkursi është shpallur për një (1) pozitë dhe në bazë të Raportit final të Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues Formulari Form.KQZ-R-11, kandidati i përzgjedhur ka arrit gjithsejtë 82.2. pikët e përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, ndërsa ankuesi Rujdi Mazreku pas vlerësimit të testit me shkrim dhe intervista me gojë ka arritë gjithsejtë 64.4 pikë. Ndërsa sipas njoftimit për kandidatin e suksesshëm të datës 10.03.2023 me pikët e fituara gjatë procedurës së përzgjedhjes ka arritë gjithsejtë 82.2. pikët.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se procedura e rekrutimit nga Sekretariati i Komisionit Qendror Zgjedhor për pozitën "Zyrtar i Lart Komunal i Zgjedhjeve" në Mamushë, është bërë në pajtim edhe me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: "Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës", po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Sekretariati i Komisionit Qendror Zgjedhor, lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatit për pozitën "Zyrtar i Lart Komunal i Zgjedhjeve" në Mamushë, ka vepruar në pajtim me nenin 11 paragrafit 1 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcakton se: „Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji i Këshillit, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1153/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komisionin Qendror Zgjedhor dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.